




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të kërkesës së komunitetit të fshatit Gramaqel KK Deçan, të dt.17.01.2018, nr.02-1663, për përkrahje me karburante për hapjen e një kanali të ujitjes së tokës së fshatit në gjatësi 750 m, duke u mbështetur në nenin 55 pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës së Deçanit, me dt.14.03.2018, merr këtë:


V E N D I M

PËR FURNIZIM ME KARBURANTE PËR HAPJEN E KANALIT PËR UJITJE TË TOKËS NË FSHATIN GRAMAQEL

- I. Lejohet furnizimi me 1000 litra derivate të naftës për komunitetin e fshatit Gramaqel, për hapjen e një kanali të ujitjes së tokës së fshatit në gjatësi 750 m.
- II. Furnizimi me derivate do të bëhet në pompën e benzinës "Petrol Company" Sh.P.K. me të cilin posedojmë kontratë për furnizim me derivate dhe paguhen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
- V. Me vendim njoftohen:
 - 1.Pala,
 - 2.Zyra e Kryetarit, dhe
 - 3.Arhivi i KK Deçan.

02.Nr. _____

Dt.14.03.2018



Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj